

### **Informacion i pergjithshem**

Shoqeria "Alko – Impex General Constrution" shpk dege e shoqerise se huaj ( shoqeri Kosovare) eshte regjistruar si shoqeri me pergjegjesi te kufizuara ne QKR. Ortaket e shoqerise "Alko – Impex General Constrution" shpk dege e shoqerise se huaj ( shoqeri Kosovare) Alko Impex General zoterohen nga Imer Ademi dhe administrator i shoqerise "Alko – Impex General Constrution" e cila zhvillon aktivitetet ne Shqiperi eshte Arber Abazi . Adresa e shoqerise dega ne Shqiperi eshte Rruga "Reshit Petrela" , kompleksi Usluga , kati i tete prane stacionit te trenit Tirane.

Shoqeria ka objekt kryesor te veprimtarise se saj thyerja e gurit dhenja e formes dhe finicioni; ndertimi i larte dhe ndertimi i ulet; ngritja dhe mbulimi i konstruksioneve te kulmeve; ndertimi i autostradave, rugeve, aeroporteve dhe objekteve sportive; punime te tjera te specializuara te ndertimit, vendosja e instalimeve te kanalizimit fekal dhe atmosferik; vendosja e instalimeve elektrike; vendosja e izolatoreve etj. grumbullim, pastrim, perpunim dhe riciklim i mbetjeve urbane. Grumbullim, perpunim dhe shitje skrapit te ndryshme. Pastrimin e ambienteve te brendshme dhe te jashtme dhe sistemim-gjelberim. Menaxhimi, riciklimi dhe trajtimi i mbetjeve te ndryshme. Sherbime lavanderie dhe dizinfektimi. Riparim i mjeteve motorike (servis). Tregtim automjetesh, pjeseve motorike.

Shoqeria eshte e regjistruar ne organet tatimore dhe ka NIPT K91326028I, shoqeria ka nje numer punonjeshish ne fund te vitit 2020 prej rreth 347 vetash.

### **Baza e Pergatitjes dhe e politikave te rendesishme kontabile**

Pasqyrat financiare te shoqerise "Alko – Impex General Constrution" shpk. jane pergatitur ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) te permiresuara dhe politikat e kontabilitetit ne vijim. Pasqyrat financiare jane pergatitur me modelin e koston historike.

Pergatitja e pasqyrave financiare kerkon qe drejtimi te beje gjykime, vleresime dhe supozime rreth aplikimit te politikave kontabel dhe vlerave te raportuara te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund te ndryshojne nga keto vleresime.

Vleresimet dhe supozimet e lidhura me to rishikohen vazhdimisht. Rishikimet ndaj vleresimeve kontabel njihen ne periudhen ne te cilen ndodh rishikimi dhe periudhat e ardhshme ne rast se ky ndikon ne periudhat aktuale dhe ato te pritshme.

### **Paraqitja e transaksioneve ne monedhe te huaj**

Monedha funksionale e shoqerise eshte leku shqiptar, monedha e vendit ne te cilen operon Shoqeria. Pasqyrat financiare paraqiten ne monedhen funksionale, Lek.

Transaksionet ne monedhe te huaj regjistrohen me kursin e kembimit te dates se kryerjes se transaksionit.

### **Njohja e te ardhurave**

Shoqeria realizon te ardhura nga veprimtaria e saj kryesore qe eshte punime ndertimi. Keto te ardhura njihen nenga shoqeria ne momentin e shitjes .

#### **Te ardhura nga interesat**

Te ardhurat nga interesat njihen kur ato maturohen. Te ardhurat nga interesat, rrjedhin nga llogarite korente ne bankat me te cilat operon shoqeria.

#### **Aktivitet afatgjata materiale**

Aktivitet afatgjata materiale (AAM), te cilat plotesojne kriteret site tilla, vleresohen fillimisht me kosto blerje ose prodhimi. AAM paraqiten ne bilanc me vleren neto (minus amortizimin e akumuluar dhe zhvleresimin, nese ka).

#### **Zhvleresimi i aseteve**

AAM me nje jetegjatesi te percaktuar, rishikohen per humbje nga zhvlersimi, kurdohere qe ngjarje ose ndyshime ne rrethana, tregojne qe vlera e mbetur mund te mos rikuperohet. Humbja nga zhvleresimi njihet per shumen per te cilen vlera e mbetur kalon vleren e rikuperueshme.

#### **Inventaret**

Inventare te tjera te blera jane vleresuar me kosto blerje, ato kalojne ne shpenzime sipas konsumit te tyre.

#### **Llogarite e arketueshme**

Llogarite e arketueshme klasifikohen si kliente dhe debitore te tjere. Ato lindin kur shoqeria i siguron sherbime ose para, direkt nje debitori dhe nuk ka asnje qellim tregtimi te llogarive te arketueshme. Llogarite e arketueshme paraqiten ne bilanc ne aktivet aftshkurtra .

#### **Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre**

Paraja dhe ekuivalentet e saj perfshijne, parate ne arke, llogarite rrjedhese dhe fondet e ngurtesuara e vendosura ne banka.

#### **Tatim fitimi**

Norma e aplikuar per tatim fitimi per vitin 2020 eshte 15% sipas legjislacionit fiskal ne fuqi. Ne vitin 2020, shoqeria ka llogaritur tatim fitimi ne vleren 3,374,174 leke. Fitimi neto i realizuar nga shoqeria per vitin 2020 eshte 19,120,317 leke.

Shoqeria llogarit dhe paguan kontributet per sigurime shoqerore dhe shendetsore per punonjesit sipas ligjeve ne fuqi,

#### **Mjete monetare**

**SHENIMET SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE PER VITIN E MBYLLUR NE 31 DHJETOR 2020**

Mjetet monetare te Shoqerise dhe ekuivalentet e tyre paraqiten te detajuara ne tabelen e meposhtme:

**GJENDJA E LLOGARIVE SIPAS BANKAVE PARAQITET:**

<b>EMERTIMI I BANKAVE</b>	<b>SIPAS REGJ</b>	<b>FIZIKISHT</b>	<b>DIFERENCE</b>
BKT	64,203,930.53	64,203,930.53	-
OTP BANK	2,836,822.87	2,836,822.87	-
UNION BANK	1,269,625.62	1,269,625.62	-
CREDINS BANK	993,488.00	993,488.00	-
BKT EURO	45,297.69	45,297.69	-
<b>SHUMA TOTALE</b>	<b>69,349,164.71</b>	<b>69,349,164.71</b>	<b>-</b>

Per sa i takon llogarise se bkt-se ne euro gjendja me date 31.12.2020 eshte 366.19 euro kursi i dates eshte marre 123.7 leke.

**Llogarite e arketueshme**

Llogarite e arketueshme perbehen nga kerkesa qe kane te tretet ndaj shoqerise . Ndryshime ne kete post ne krahasim me vitin e kaluar eshte 114,121,572 leke.

<b>► Të drejta të arkëtueshme</b>	<b>2020</b>	<b>2019</b>
1 <i>Nga aktiviteti i shfrytëzimit</i>	325,847,721	440,462,892
2 <i>Nga njësitë ekonomike brenda grupit</i>		
3 <i>Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>		
4 <i>Të tjera (detyrime tatimore)</i>	508,087	
5 <i>Të tjera (detyrime doganore)</i>	43,200	57,688
	<b>326,399,008</b>	<b>440,520,580</b>

Ne zerin lende e pare dhe materiale te konsumueshme ne shumen 37,706,343 leke eshte gjendja e inventarit me date 31.12.2020 dhe paraqitet si me poshte :

<b>Nr</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasi</b>	<b>Çmim</b>	<b>Vlefte</b>
1	CIMENTO	TON	3,152	8,500	26,792,000
2	HEKUR	KG	65,661	75	4,924,590
3	DIESEL	LIT	19,412	121	2,348,852
4	TULLA	COPE	26,928	27	727,056
5	GELQERE	KG	1,500	9	13,500
6	LLAMARINE	KG	14,357	85	1,220,345
7	PROFILE HEKURI	KG	24,000	70	1,680,000
	<b>Shuma</b>				<b>37,706,343</b>

**SHENIMET SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE PER VITIN E MBYLLUR NE 31 DHJETOR 2020**

Ne zerin inventar i imet ne shumen 9,207,988 leke eshte gjendja e inventarit me date 31.12.2020 dhe paraqitet si me poshte :

NR	PERSHKRIMI	SASIA	CMIMI	VLERA
1	GOMA	521	13,021	6,783,848
2	KAZANE	100	16,667	1,666,700
3	FSHESA, MJETE PER PASTRIM	360	2,104	757,440
	<b>TOTALI</b>			<b>9,207,988</b>

**Aktive afatgjata**

Ne grupin e AAGJM ka ndryshim nga viti i kaluar pasi shoqeria ka blere dhe ka shitur aktive mjete transporti.

Inventari I asetëve, zeri paisje zyre dhe informatike gjendje me datë 31.12.2020 është :

ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCTION VITI 2020					
	Vlera	Blerje	Amortizimi	Shitje	VRN 2020
Mjete transporti	51,184,599	247,800	1,278,629	2,141,867	48,011,903
Pajisje informatike	329,914	86,172	77,221		338,865
Mobilje e pajisje zyre	102,247		20,449		81,798
<b>TOTALI</b>	<b>51,616,760</b>	<b>333,972</b>	<b>1,376,299</b>	<b>2,141,867</b>	<b>48,432,566</b>

Vlera 9,583,333 leke ne bilanc jane parapagime per blerjen e mjeteve te transportit.

Shoqeria per vitin 2020 ka llogaritur amortizim ne vleren 1,376,299 leke i cili eshte llogaritur sipas normave ne fuqi.

Ne aktiv te bilancit ne postin aktivet afatgjata jane paraqitur AAM te cilat jane vleresuar sipas SKK5 ku aktivet afatgjata vleresohen me vleren kontabile neto pra nje aktiv njihet ne bilanc (pasi zbritet amortizimi i akumuluar dhe humbjet e mundshme nga zhvleresimi) dhe i perkasin kompanise. Vlera e tyre neto eshte 48,432,566 leke. Per vitin 2020 jane shitur tre mjete transporti me vlere 2,141,867 leke.

## 1. Detyrimet te tjera

► Detyrime afatshkurtra:	2020	2019
1 Titujt e huamarrjes		
2 Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	0	0
3 Arkëtime në avancë për porosi		
4 Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	382,147,893	483,184,077
5 Te pagueshme ndaj punonjesve		
6 Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike brenda grupit		
7 Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse	1,715,273	1,715,273
8 Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore	10,757,321	8,085,001
9 Të pagueshme për detyrimet tatimore	495,588	3,079,359
<b>TOTALI</b>	<b>395,116,075</b>	<b>496,063,710</b>

Ne detyrime afatshkurtra jane detyrimet ndaj furnitoreve ne shumen 382,147,893 leke.

Vlera ne shumen **10,757,321** leke perbehet nga :

Pagat e punonjesve ne shumen 7,693,074 leke

Tatimi mbi page 57,939 leke

Kontributi i sig shoq dhe shend 3,006,308 leke

Vlera ne shumen **495,588** leke perbehet nga :

Nga tatim fitimi 492,468 leke

Tatimi ne burim 3,600 leke

## 2. KAPITALI AKSIONAR

Kapitali aksionar nuk ka pesuar ndryshime gjate vitit 2020 paraqitet si me poshte.

Kapitali	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Kapital i autorizuar (ne Leke)	195,227	195,227
Vlera nominale per aksion (ne Leke)	195.227	195.227
Nr. i aksioneve	1,000	1,000

**Te ardhurat**

Te ardhurat e Shoqerise per vitin 2020 paraqiten me poshte te detajuara sipas llojit te tyre:

Ne Leke

	Viti 2020	Viti 2019
Te ardhura nga shitja	573,754,400	700,582,753
Te ardhura te tjera	2,984	943
Total	<u>573,757,384</u>	<u>700,583,696</u>

Zeri te ardhurat nga shitja vijne nga sherbimet e kryera sipas situacioneve perkatese ndaj klienteve te shoqerise.

Zeri te ardhura te tjera perfshin te ardhurat nga interesat bankare si dhe fitimi nga kursi i kembimit per veprimet e kryera ne monedhen euro.

**Shpenzime Materiale**

Ne Leke	Viti 2020	Viti 2019
Materialet e konsumuara	432,605,213	583,186,003
Totali	<u>432,605,213</u>	<u>583,186,003</u>

Vlera 432,605,213 leke ne bilanc perbehet nga blerjet e ndryshme qe ka bere firma per kryerjen e sherbimeve te ndryshme, blerje te tilla si shpenzime per karburant, blerje per materiale te ndryshme elektrike, hidraulike, materiale ndertimi, shpenzime karburanti, blerje materialesh per mirembajtje rrugore, etj.

**Shpenzime Personeli**

Ne Leke	Viti 2020	Viti 2019
Shpenzime per paga	89,560,861	70,807,322
Kontribute per sigurime	15,261,160	11,825,633
Totali	<u>104,822,021</u>	<u>82,632,955</u>

**Shpenzime te tjera**

Shpenzimet te tjera operative analizohet si me poshte:

Ne Leke	Viti 2020
Shpenzime te tjera	12,351,890
Total	<u>12,351,890</u>

Ne zerin shpenzime te tjera perfshihen pagesat e qerase gjate vitit 2020, pagesat e taksave vjetore te bashkive, taksave te mjeteve si dhe pagesa te ndryshme per garanci.

Ne vitin 2020 shoqeria ka dale me nje fitim neto ne vleren 19,120,317 leke.

Ngjarje pas dates se raportimit

Nuk kane ndodhur ngjarje te tjera pas dates se raportimit qe do te kerkonin rregullime dhe shenime shtese ne pasqyrat financiare.

**12.03.2021**

**Hartuesi**

**Ana Voci**



**ADMINISTRATORI**

**Arber Abazi**

